



Efektet e shumëfishta të zvarritjes së procesit të integrimit

Ledion Krisafi

Shqipëria gjendet prej disa vitesh tashmë në pritje të mbajtjes së konferencës së parë ndërqeveritare me Komisionin Evropian, që do të shënjonte dhe fillimin zyrtarisht të nisjes së negociatave me Bashkimin Evropian. Kryeministri Rama nga Ukraina deklaroi përsëri se nuk beson që bisedimet do të fillojnë as këtë verë, në samitin e BE-së në 23 qershor. Sipas tij arsyeja vazhdon të jetë vetoja e Bullgarisë ndaj Maqedonisë së Veriut. Vitet e fundit arsyet e mosnismës së bisedimeve kanë qenë të ndryshme duke kaluar nga ato të brendshme në Shqipëri tek ato të brendshme në Maqedoninë e Veriut me të cilën Shqipëria çuditërisht është bashkëlidhur nga Komisioni Evropian në rrugën drejt BE, tek tashmë vetoja e Bullgarisë ndaj Maqedonisë së Veriut.

Pritja për nisjen e bisedimeve është në vazhden e zvarritjes së gjithë procesit të integrimit të Ballkanit Perëndimor që tashmë ka hyrë në dekadën e tretë pa patur ende një shenjë se kur mund të përfundojë. Perspektiva e anëtarësimit në Bashkimin Evropian ka qenë ndoshta shtyja më e fuqishme në shndërrimin politik, social dhe ekonomik të rajonit të ndodhur pas përfundimit të luftrave shpërbërëse të ish Jugosllavisë. Të gjitha vendet e rajonit u futën në një proces madhor ndryshimi dhe përafrimi të gjithanshëm me Bashkimin Evropian. Nga ana tjetër zbehja e kësaj perspektive ka efektin e kundërt ku në shumë vende proceset demokratike kanë ngecur në vend ose dhe mund të jenë kthyer pas si në rastin e Serbisë ku kontrolli mediatik dhe administrativ në shërbim të pushtetit të Aleksandar Vuçiçit është i pashembullt në rajon.

Shtetet e rajonit nisën të reformonin administratat e tyre publike, sistemet e drejtësisë, tregjet e tyre të brendshme dhe të rinisnin bashkëpunimin rajonal të harruar për shkak të luftrave të viteve 90-të. Pasojë e këtij procesi madhor është fakti që sot rajoni është më afër idealeve mbi të cilat është ndërtuar Bashkimi Evropian se sa të shkuarës së viteve 90-të dhe mundësia e një kthimi pas për rajonin duket thujtë e pabesueshme.

Por zbehja e anëtarësimit të shpejtë në BE në vitet e fundit ka ndikuar që vendet e rajonit, duke përfshirë dhe Shqipërinë, të arrijnë një pikë thujtë stanjacioni në drejtim të vazhimit të reformave dhe përafrimit me standartet e Bashkimit Evropian. Pushteti është bërë më i përqëndruar në një dorë ose pak duar, mediat janë bërë më pak të lira dhe të kapura nga pushtetet politike dhe financiare, njerëzit vetë e kanë gjetur integrimin duke emigruar masivisht në vendet e Bashkimit Evropian ndërkohë që "aktorë" të tjerë si Rusia, Kina dhe Turqia kanë shtuar praninë e tyre në rajon.

Në rastin e Shqipërisë entuziazmi i anëtarësimit në BE tashmë është zbehur pasi është kuptuar që kjo nuk do të ndodhë shpejt dhe që as anëtarësimi nuk është një shenjë e nivelit më të lartë të të ardhurave

ose një shteti më demokratik dhe institucional, siç tregojnë rastet e Bullgarisë dhe Rumanisë të cilat kanë ende probleme bazike me korrupsionin dhe shtetin e së drejtës 15 vite pas anëtarësimit në BE, ndërkohë që gjithashtu niveli i tyre i jetesës gjendet ende në fund të vendeve të BE-së; ndërkohë që raste si Polonia dhe Hungaria tregojnë që edhe duke qenë brenda BE-së shtetet mund të bëjnë hapa pas në drejtim të demokracisë dhe shtetit ligjor. Në këtë këndvështrim idealet e zhvillimit ekonomik, demokracisë dhe shtetit ligjor që entuziazmonin shqiptarët në rrugën drejt BE-së tashmë janë venitur.

Shqipëria vazhdon të ketë ende probleme të mëdha me korrupsionin në nivele të larta, me mosfunksionimin dhe politizimin e skajshëm të administratës shtetërore pavarësisht përpjekjeve të shumëfishta në të paktën 15 vitet e fundit për ta reformuar dhe depolitizuar, vazhdon të ketë probleme me organizimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme pavarësisht tre dekadave të rekomandimeve të OSBE-ODIHR për zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Pavarësisht ndryshimeve të mëdha digjitale dhe marrjes së shërbimeve që ka sjellë e-albania në vitet e fundit, administrata shtetërore vështirë se mund të reformohet në atë pikë sa të quhet e depolitizuar, asnjë parti në pushtet nuk do të heqë dorë nga një aset shumë i vlefshëm sidomos në raste zgjedhjesh; pavarësisht nga reformimi në kryerje e sipër i sistemit të drejtësisë dhe organeve të reja si SPAK, BKH, Gjykata për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, decentralizimi i sistemit duke mos përqëndruar gjithçka në dorë të Prokurorisë së Përgjithshme dhe zgjedhja e gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj duke përfshirë shumë institucione të pavarura, prapë asnjë prej tyre nuk po arrin të godasë as korrupsionin e tanishëm në nivele të larta dhe as korrupsionin e 30 viteve të fundit; pavarësisht rekomandimeve të vazhdueshme të OSBE-ODIHR për zgjedhje të lira, të ndershme dhe të depolitizuara, dhe pavarësisht përparimit që gjithsesi është bërë në këtë drejtim, Shqipëria vazhdon të organizojë zgjedhje jo të nivelit të një shteti që kërkon të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian. Të gjitha këto ngecje, pavarësisht përparimeve të atyqytësueshme, përkeqësohen nga ngecja e procesit të integritetit dhe zbehja e entuziazmit në lidhje me integrimin tek popullsia në përgjithësi. Zvarritja e procesit heq nxitjen për të vazhduar ndryshimet.

Një efekt tjetër i rëndësishëm dhe i dëmshëm është tek vetë partia në pushtet. Partia Socialiste mbush këtë shtator 9 vite në pushtet dhe pritet të jetë aty të paktën deri në shtatorin e vitit 2025, në mos Edi Rama arrin të bëjë përsëri histori dhe të fitojë për herë të katërt rradhazi. Një parti që fiton dhe veçanërisht një parti që fiton kaq shumë dhe kaq thellë sa PS-ja e 9 viteve të fundit, nuk ka shumë shtysë për të ndryshuar. Një administratë e depolitizuar do të thoshte humbje e një pushteti shumë të vlefshëm në rast zgjedhjesh, zgjedhje tërësisht të lira dhe të ndershme ndoshta nuk do të kishin të njëjtin rezultat për partinë në pushtet, lufta e plotë ndaj korrupsionit në nivele të larta do i hiqte partisë një pjesë të konsiderueshme të ardhurash, lidhjesh me biznesin dhe mundësi shfrytëzimi të tij në fushatë.

Në pjesën ekonomike, zvarritja e procesit të integritetit heq shtysat për të krijuar një treg vërtetë të lirë dhe konkurrence të lirë si një prej kritereve të Kopenhagenit. Tregu në Shqipëri vitet e fundit ka ardhur gjithmonë e më shumë duke u monopolizuar me një grusht kompanish të cilat të ndihmuara në mënyrë të ndjeshme dhe nga koncesionet dhe tenderat shtetërore, po marrin në dorë gjithmonë e më shumë

pjesë të ekonomisë shqiptare duke shkatërruar konkurrencën e lirë dhe mundësinë e investimeve të rëndësishme të huaja. Nga një treg i hapur po shndërrohet në një treg të mbyllur.

Në politikën e jashtme, zvarritja e mëtejshme e procesit i jep hapësirë “aktorëve” të tjerë në rajon. Shqipëria edhe para fillimisht të luftës në Ukrainë, kishte marrëdhënie minimale politike dhe ekonomike me Rusinë, kështu që Rusia nuk ka qenë asnjëherë një nga ata “aktorët” e jashtëm alternativë ndaj BE-së. Ndërkohë, marrëdhëniet me Kinën e kanë humbur entuziazmin e disa viteve më parë duke u shndërruar sot thujse në marrëdhënie kortezie ndërkohë që nuk flitet më për investime të rëndësishme kineze në Shqipëri. Përkundrazi, duket se qëllimi është largimi dhe i atyre investimeve kineze që kanë mbetur në Shqipëri, siç është koncesioni i naftës. Nga ana tjetër, “aktori” i tretë i rëndësishëm në Ballkan, Turqia, përkundër Rosisë dhe Kinës, e ka rritur praninë e saj në Shqipëri. Ndikuar dhe nga një marrëdhënie personale e Kryeministrit Rama me Presidentin turk Erdogan, Turqia ka shtuar veprimtarinë e saj në Shqipëri në investime, tregti, pjesë e rëndësishme e rindërtimit pas tërmetit të 26 nëntorit, ndërtimit të xhamive të reja ose rinovimit të atyre ekzistuese dhe të gjithë trashëgimisë osmane në Shqipëri, në fushën ushtarake, në investime në arsim duke marrë në zotërim universitete, shkolla të mesme, Medrese, në spitale si ai i Fierit i ndërtuar për dy muaj dhe së fundi edhe në lidhje me Islamin në Shqipëri, Turqia ka shtuar ndikimin e saj dhe përpiqet të krijojë një monopol mbi islamin shqiptar. Turqia është shndërruar ashtu siç thotë kryeministri Rama në “opsionin e fundit” kur çdo gjë tjetër nuk ka funksionuar dhe në fund ngelet Turqia. Kështu ndodhi me vaksinat gjatë pandemisë së Covid-19 kur Shqipëria nuk po merrte vaksinat që i ishin premtuar nga Bashkimi Evropian dhe marrëveshja me Pfizer, vaksinat kineze në Shqipëri erdhën nga Turqia duke shpëtuar qindra jetë njerëzish por dhe duke ndihmuar kryeministrin Rama të kalonte një moment të vështirë.

Këto zhvillime, në opinionin publik mund të krijojnë përshtypjen se Turqia është më ndihmuese, më e rëndësishme se Bashkimi Evropian. Ndërkohë që Turqia në opinionin publik ndërlidhet me ndihmën e pakursyer që jep në çdo rast, Bashkimi Evropian lidhet me zvarritjen e procesit të integritit, me vetot e herëpashershme të Francës a Hollandës. Vazhdimisht në sondazhet e zhvilluara vitet e fundit nga Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare, Turqia rradhitet kah Shteteve të Bashkuara për pozitivitetin me të cilin shihet prania e saj në Shqipëri, megjithëse gjithë historiografia shqiptare e shekullit të fundit është ndërtuar mbi anti-otomanizmin si një faktor themelor i prapambetjes historike të Shqipërisë.

Si përfundim, efektet e shumëfishta të zvarritjes së procesit të integritit dhe mosnjohjes së negociatave, prekin thujse çdo sferë të jetës politike, ekonomike, sociale dhe ndërkombëtare të Shqipërisë. Efekti i përmbledhur i gjithë sa u tha më sipër shfaqet tek emigracioni i lartë nga Shqipëria drejt vendeve të Bashkimit Evropian. Pas tridhjetë vitesh në pritje, njerëzit e kanë marrë vetë në dorë integritin duke e kërkuar në vendet e BE-së atë që BE-ja ka premtuar dhe premtton se do e krijojë në Shqipëri pikërisht përmes procesit të integritit dhe përafrimit me BE-në.

Ky shkrim është pjesë e Projektit “Media dhe Integriti Evropian”, te Institutit Shqiptar të Medias, në kuadrin e Programit të Promovimit të Tranzicionit të Republikës Çeke.